

1. Çfarë është papilloma virus njerëzore?

Virusi i papilomës njerëzore (Papiloma virus ose HPV) është përgjegjësi i kancerit në qafën e mitrës, i pari tumor i njohur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si tumor totalisht me prejardhje nga një infeksion.

Ekzistojnë 1200 lloje të ndryshme nga këndvështrimi gjenetik (gjenotipe) të virusit HPV, i aftë të infektojë njeriun, një e treta është i lidhur me sëmundjet (patologjike) të pjesës anogenitale, qoftë beninjë ashtu edhe malinjë. Nga këta gjenotipe, tipi 16 është përgjegjës i gati 50% të rasteve të kancerit në qafën e mitrës, tipi 18, përgjegjës i 20 % dhe pjesa mbetëse 30%. Gjenotipet 6 dhe 11 janë përgjegjës të lythave gjenitale.

2. Si ndeshet ky infeksion?

Infeksioni nga HPV është më i përhapuri në infeksionet nëpërmjet trasmetimit seksual. Kështu, për të trasmetuar këtë infeksion është e mjaftueshme një kontakt i thjeshtë në zonën gjenitale (edhe raport seksual jo i plotë). Prania e mbartësve të shëndoshë është shumë e përhapur në shoqëri. Në përgjithësi qoftë burri ashtu edhe gruaja nuk paraqesin shënja të dukshme të infeksionit, edhe pse janë në gradë ta trasmetojnë atë. Profilaktikët (prezervativët), duhet të përdoren gjithmonë për parandalimin e sëmundjeve seksualisht të trasmetueshme, por nuk garantojnë mbrojtje të plotë kundrejt virusit HPV.

3. Cilat janë shqetësimet që shkakton infektimi nga HPV?

Infektimi nga virusi HPV, nuk paraqet asnjë shqetësim të vecantë. Pjesa më e madhe e infeksioneve shërohet në mënyrë spontane pa pasoja. Vetëm një minorancë e infeksioneve bëhet kronike, dhe është pikerisht në këto situata që virusi, në zhvillim edhe brenda pak viteve, mund të çojë në plagët ose çarjet para – kanceroze. Në fakt nëse këto shenja nuk njihen (nëpërmjet Pap-testit) dhe nuk kurohen në mënyrën e duhur mund të kthehen në kancer të qafës së mitrës.

4. Si përballohet infektimi nga Papiloma virus?

Për infeksionin nuk ekziston një kurë e posaçme. Për parandalimin dhe diagnostikimin në mënyrë të menjëhershme ndryshimin e qelizave të qafës së mitrës që mund të jenë të provokuara nga ky virus, kërkohet të kryhet në mënyrë të rregullt Pap-test (testi i Papanikolaut, për nder të ideatorit). Flitet për një analizë, në gjendje të verifikojë ndryshimin e qelizave në qafën e mitrës. Në këtë mënyrë është e mundur të kuptohet në kohë që po formohen ndryshime të dyshimta në materialet e qafës së mitrës. Është e dukshme pra që vaksina, nuk kuron, por parandalon infeksionin.

5. Ka shërim nga ky infeksion?

Kur është marrë infeksioni nga një ose disa tipe të papiloma virus, është imuniteti i trupit që çon në shërim, në pjesën më të madhe të rasteve. Tipet 16 dhe 18 janë shpesh përgjegjes të infeksioneve kronike dhe të kalimit pas 10 vjetëve në kancer të qafës së mitrës.

6. Mund të merret për herë të dytë?

Po, teorikisht është e mundur të merret për herë të dytë infeksioni me të njëjtin tip të HPV, sepse mbrojtjet e brendshme të trupit, imuniteti, është i fortë, por zgjat pak : çarja është e lokalizuar dhe virusi nuk emigron në gjak.

Vetëm vaksina dominon nivelin mbrojtës të paktën 10 herë më shumë, konsiston për më shumë se 8 vjet.

7. Çfarë rëndësie ka HPV në gjenerimin e tumorit të qafës së mitrës?

Infeksioni i përhershëm nga virusi HPV onkogjen (i aftë domethënë të gjenerojë tumore) është pra një kusht i domosdoshëm për të zhvilluar tumorin në qafën e mitrës. Në këto raste virusi hyn thellë në qelizat e mukozës (cipat që veshin mitrën) dhe i ndryshon në mënyrë progresive deri sa të krijojë të çarat, plagët para-tumorale të ashtuquajtura CIN -2 dhe CIN -3: që tregojnë ndryshime të shkallës së mesme dhe të lartë. Ky proces kërkon kohë të gjatë, edhe disa vjet, dhe të çarat mund të kurohen nëse diagnostikohen në kohë. Probabiliteti që një infeksion nga HPV mos të shërohet në mënyrë spontane, e të kthehet në kronike varet nga lloji i HPV, dhe është më e lartë për HPV 16. Virus HPV gjendet gjithashtu në 99.7 % në karcinomat e qafës së mitrës, dhe kjo tregon pikërisht që pa prezencën e një infeksioni kronik nga HPV nuk mund të jetë tumor. Tymi i cigares, përdorimi për kohë të gjatë i kontraceptivëve nga goja, numri i shumtë i partnerëve, prekja nga infeksioni HIV dhe lindja e shumë fëmijëve janë faktorë që favorizojnë mundësinë e zhvillimit të një tumori.

8. Vaksinimi kundër HPV 16 dhe 18 ndalojnë infeksionin?

Vaksinimi është demonstruar i aftë të pengojë krijimin e infeksioneve akute nga HPV, shkaktuar nga tipet virale që përmban vaksina, pengon kalimin në infeksion kronik dhe zhvillimin e tij deri në çarjet para-kancerogjene (të domosdoshme për të arritur në tumorin e vërtetë).

9. Në ç'mënyrë reagon kjo vaksinë për të parandaluar tumorin në qafën e mitrës?

Vaksinat e disponueshme janë të ndërtuara nga pjesëza të ngjashme virale (si mbulesa bosh të virusit), që nuk kanë asnjë kapacitet të riprodhohen ose të infektojnë organizmin e njeriut, por që prezantojnë një formacion të jashtëm absolutisht të ngjashëm me atë të virusit të gjallë. Sistemi imunitar stimulohet në këtë mënyrë të

prodhojë antitruapat kundër proteinave të pranishme mbi sipërfaqen e virusit, kështu që në rast të ekspozimit natyral të infektimit, virusi bllokohet përpara se të hyjë në qelizat e mukozave gjenitale. Janë dy formulime të ndryshme të vaksinës kundër virusit HPV: një formulim përmban proteina të virusit HPV 16 dhe HPV 18, edhe ato të tipit HPV 6 dhe HPV 11. Vaksina kryen një veprim parandalues dhe nuk është efikase kundër virusit që ka hyrë në kontakt me mukozën. Kështu pra, vaksina i drejtohet kryesisht personave të painfektuar. Kjo vaksinë është demonstruar më e fortë përse i përket imunitetit në personat me moshë të re, që nuk kanë kontakte me HPV, dhe në këtë mënyrë kjo vaksinë është ofruar kryesisht për vajzat që kanë mbushur 11 vjeç.

10.Kush përfiton gratis nga kjo vaksinë?

Në Toskanë oferta gratis e vaksinës, nëpërmjet lajmërimit nga ana e Ndërrmarjes Shëndetësore USL, ju drejtohet të gjitha adoleshenteve, duke nisur nga 12 vjeç (11 vjeç të mbushura). E drejta e vaksinimit falas, edhe në rast të pjesëmarrjes me vonesë, lejon që deri në 18 vjeç të fillojë cikli i vaksinimit.

11.Të gjitha vajzat që kanë të drejtën e vaksinimit falas, do të kontaktohen nga USL?

Ndërrmarja shëndetësore USL e zonës do të marrë masa tju dërgojë të gjitha vajzave në vitin e tyre të dymbëdhjetë, pra pasi të kenë mbushur 11 vjeç, një ftesë për tu vaksinuar. Kjo ftesë për vaksinim do t'ju ridërgohet edhe vajzave 16 vjeçare që nuk i janë përgjigjur ftesës së parë. Vajzat që kanë mbushur 13, 14, 15, 17 dhe 18 vjeç, të cilave gjithashtu u takon falas vaksinimi, mund të telefonojnë ndërrmarjen për të fiksuar një takim.

12.Përse ky vaksinim në moshën 12 vjeç? Nuk është shpejt?

Në bazë të të dhënave në dispozicion, edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon si objektiv të rëndësishëm vaksinimin e vajzave përpara adoleshencës.

Lajmërimi nëpërmjet telefonatës i drejtohet të gjitha vajzave që kanë mbushur 11 vjeç, pra në vitin e tyre të 12, sepse në këte fazë është edhe përfitimi më i madh.

Kryerja e vaksinës para fillimit të mardhënieve seksuale është e këshillueshme sepse shkakton një mbrojtje të madhe përpara një infektimi të mundshëm nga virusi HPV, që kryesisht merret menjëherë pas fillimit të aktivitetit seksual, edhe sepse përgjigjet që jep sistemi imunitar në këtë moshë janë më të forta se ato të grave në faza të një moshe madhore.

Duke “pritur akoma ndonjë vit” sepse “vajza ime është akoma e vogël” mund të paraqesë një gabim serioz, sepse humbet kështu një mundësi të shkëlqyer për t'ju përgjigjur trupi sa më mirë vaksinës, e duke qënë të sigurt për mbrojtjen përpara çdo lloj mundësie infektimi.

13. Vaksina është e sigurt?

Të dyja vaksinat e disponueshme janë të sigurtat. Janë kryer qindra mijra doza vaksinash në botë, pa asnjë lloj pasojë të shkaktuar nga to. Disa efekte anësore të lehta janë të mundshme në një pjesë të vajzave të vaksinuara, që konsistojnë në dhimbje, fryrje dhe skuqje të krahut në të cilin bëhet vaksina, dhimbje koke ose ndonjëherë edhe pak temperaturë. Të gjitha këto efekte zhduken në mënyrë spontane brenda pak ditësh dhe pa asnjë pasojë.

14. Është efikase vaksina?

Nga studimet klinike mbi sigurinë e vaksinës, rezulton që vaksina nëse kryhet kur femra nuk ka akoma kontakte me virusin, siguron një mbrojtje të lartë (90 -100%) përsa i përket çarjeve para-kanceroze të provokuara nga HPV të tipit 16 dhe 18.

15. Cilat janë kundërpasojat e kësaj vaksine?

Vaksina nuk është e këshillueshme në rast alergjie të një doze të mëparshme të së njëjtës vaksinë, ose të ndonjë prej elementeve të saj. Gjithashtu nuk duhet të kryhet në rast sëmundje të shoqëruar me temperaturë. Në këtë rast, vaksinimi shtyhet pas shërimit.

16. Gratë shtatzana mund të vaksinohen?

Vaksinimi nuk mund tju kryhet grave shtatzana. Studimet nuk kanë treguar probleme të veçanta për nënën ose fetusin në rast vaksinimi të kryer gjatë një shtatzanie të paditur, por provat që vaksina është e padëmshme janë të pakta e kërkojnë studime të mëtejshme.

17. Sa zgjat efekti i vaksinës?

Nuk dihet akoma në mënyrë përfundimtare, edhe pse aplikimi i vaksinimit në shkallë të gjerë është bërë në 5 vitet e fundit. Gjithashtu , studimet e kryera tek vajzat e vaksinuara më herët nuk ka asnjë rënie të nivelit mbrojtës nga vaksina. Nëse në të ardhmen do të manifestohet ndonjë rënie e nivelit mbrojtës pas disa vitesh, mund të kryhet një tjetër doze vaksinimi për të forcuar në këtë mënyrë mbrojtjen.

18. Është e mundur të vaksinohesh pas 18 vjetëve?

Po, vaksina është e aftë të stimulojë sistemin mbrojtës imunitar edhe tek gratë në moshë të madhe dhe të mbrojtë në drejtim të virusit HPV, edhe pse mundësia për të hyrë në kontakt me virusin rritet me rritjen e moshës, kështu që vaksina pakëson

efektet e saj. Vaksina është e mundshme deri në 45-49 vjeç, si masë mbrojtëse personale.

19.Parashikohet vaksinimi edhe tek meshkujt?

Nuk parashikohet për momentin një ofertë gratis e vaksinimit për meshkujt, sepse për ta nuk ka asnjë rrezik siç është për shembull tumori i qafës së mitrës tek femrat. Megjithatë vaksinimi është i efektshëm edhe tek meshkujt për parandalimin e lythave në organet gjenitale dhe të çarave para-kanceroze (të çara që transformohen në tumore) tipike të gjinisë mashkullore (anus, penis, etc). Vaksinimi te meshkujt sot është i mundur si masë parandaluese personale.

20.Cilat janë intervalet kohore të lejuara per kryerjen e vaksinës anti HPV, nga një dozë tek tjetra, që vaksina të jetë e efektshme?

Është gjithmonë e rekomandueshme të ndiqen udhëzimet mbi vaksine HPV (3 doza sipas skemës, 0, pas 1-2 muaj, pas 6 muaj). Në rast kjo skemë nuk ka qenë e mundur, nuk është asnjëherë e domosdoshme të fillohet vaksinimi nga fillimi.

21.Cilat janë përfitimet nga zgjatja e vaksinimit?

Flitet për sëmundje që zhvillohen në kohë të gjatë, të gjitha përfitimet nga oferta e zgjatur e vaksinimit do të jenë të dukshme kur grupet e vaksinuara do të kenë një frekuentim të pakët të çarjeve para-kanceroze (të çara që çojnë në transformime tumorale) të shkaktuara nga virusi HPV 16 dhe 18. Praktikisht do të ketë një ulje të rasteve të kancerit në qafën e mitrës.

22. Si kryhet vaksinimi?

Vaksinimi parashikohet të kryhet në rrugë muskulare, në pjesën e lartë te krahut, doza e parë, dhe dy doza të tjera pas 1-2 muajsh, dhe e fundit pas 6 muajsh nga doza e parë.

23.Ku kryhet vaksinimi?

Vaksinimi mund të kryhet falas në qendrat e vaksinimit të Ndërrmarjeve Shëndetësore lokale (AUSL) të Toskanës.

24.Vaksina zëvendëson kontrollin periodik (screening Pap-test)?

Është e domosdoshme të kujtojmë që vaksina punon krah për krah, por nuk zëvendëson Pap-testin për tumorin e qafës së mitrës, aktualisht i rekomandueshëm

për gratë e moshës nga 25 deri në 64 vjeç, dhe që kryhet çdo 3 vjet. Vaksina mbron nga çarjet e shkaktuara vetëm nga dy llojet e HPV tipet 16 dhe 18, përgjegjës në 70 % të rasteve të kancerit, ndërsa Pap-testi trevjeçar lejon të verifikohen çarje para-kanceroze të shkaktuara nga të gjitha llojet e tipeve HPV edhe ato që nuk janë të përfshira në vaksinë.

25. Çfarë është HPV test? Eshtë e domosdoshme të kryhet së bashku me Pap-testin?

Testi HPV bazohet në identifikimin e tipeve HPV, që ndoshta kane infektuar organet gjenitale të gruas. Ekzekutimi i këtij testi është i domosdoshem për të stabilizuar mënyrat dhe kohën për ndërhyrjen mjekësore. Në të ardhmen, testi HPV do të zëvendësojë Pap-testin tek gratë në moshë të madhe.

26. Çfarë thuhet nga studimet e para përse i përket parandalimit nga të çarat para-kanceroze?

Tashme kemi të dhënat në distancën e 8 vjetëve nga vaksinimi i parë. Rezultatet e përfituara janë të shkëlqyera, pas 8 vjetësh në më shumë se 99 % e të vaksinuarave nuk kanë manifestuar të çara para-kanceroze. Studimet e farmaci-ekonomisë demostrojnë gjithashtu komoditetin në kosto dhe përfitim .

27. Kujt duhet ti drejtohesh për më shumë informacion?

Është e rëndësishme të flitet me mjekun ose pediatrin e familjes, dhe të kontaktohet personeli pranë qendrave të vaksinimit, konsultoreve e qendrave sociale-shëndetësore të ndërrmarjes shëndetësore lokale (AUSL) të zonës ku jetoni.